

BPrAL kolegji-heimerer	
PrEHE college-heimerer	
Nr. Prot: 111/22	Data: 25/02/2022
Prot. No: 111/22	Date: 25/02/2022
Njësia: 1	Prishtinë

Bazuar në LIGJIN NR. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS, dhe në Statutin e Kolegjit Heimerer;

Bazuar në propozimin e Këshillit Akademik të Kolegjit Heimerer të datës 23.02.2022 për rregullimin e zgjedhjes dhe avancimit të personelit Akademik të Kolegjit HEIMERER;

Me qëllim të përcaktimit të titujve dhe gradave të personelit akademik të Kolegjit HEIMERER,

Me qëllim të përcaktimit të kriterëve për zgjedhjen dhe avancimin e Stafit Akademik të Kolegjit HEIMERER;

Rektorja e Kolegjit HEIMERER, bazuar në kompetencat Statutore, me datë 25.02.2022, aprovon këtë:

RREGULLORE PËR GRADAT, TITUJT, ZGJEDHJEN DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Neni 1 – Qëllimi

Qëllimi i rregullores është krijimi i bazës ligjore për caktimin e titujve dhe gradave e Personelit Akademik dhe procedurat e përzgjedhjes dhe avancimit të stafit akademik, në përputhje dhe bazuar në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Neni 2 – Definime

KH - Kolegji Heimerer

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

AKA – Agjensioni Kosovar për Akreditim

KKK - Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

UA MASHT – Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë

Neni 3 – Angazhimi i stafit akademik të Kolegjit HEIMERER

3.1. Kolegji Heimerer në cilësinë e Bartësit Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë ushtron veprimtarinë akademike, shkencore dhe profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi përmes angazhimit të stafit adekuat. Stafi akademik i Kolegjit Heimerer është në përbërje të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve shkencorë, titujt dhe gradat e së cilëve caktohen bazuar në thirrjet shkencore – mësimore, në thirrjen e bashkëpunëtorit dhe në thirrje të punëtorit shkencor dhe akademik.

3.2. Këshilli Akademik i BPrAL Kolegji Heimerer, me propozim të Komisionit Vlerësues, gëzon lirinë dhe të drejtën për të miratuar tituj e grada dhe për të përcaktuar kriteret e emërimeve dhe të riemërimeve në bazë të Rregullativës Ligjore për Arsimin e Lartë në Kosovë.

3.3. Titujt dhe gradat e miratuara në bazë të kriterëve nga paragrafi 2 i këtij neni do të kenë mundësi të njohjes publike, për qëllime punësimi si dhe për shërbime të tjera publike në Kosovë.

Neni 4 – Gradat dhe Titujt Akademik

4.1. BPrAL Kolegji Heimerer si kolegji i licencuar nga MASHT, me programe të akredituara nga AKA, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, neni 26.5, mund të ofrojë këto thirrje akademike:

- a) Profesor;
- b) Profesor asistent
- c) Ligjërues;
- d) Asistent;

4.2. Kolegji HEIMERER ka të drejtë emërimi edhe të stafit akademik të mëposhtëm:

- a) Stafi akademik vizitor;
- b) Stafi tjetër akademik si reagim ndaj nevojave institucionale, të përcaktuara nga Këshilli Akademik.

4.3 Profesori i rregullt i pensionuar nga një post me orar të plotë, mund të caktohet si Profesor Emeritus dhe mund të thirret për të mbështetur institucionin, në të cilin ai mban këtë titull, në cilëndo mënyrë që konsiderohet e përshtatshme nga rektori.

PJESA II - PËRSHKRIMI I TITUJVE DHE GRADAVE TË STAFIT AKADEMIK

Neni 5 – Titulli dhe Grada Profesor

5.1. Ofrimi i titullit Profesor varet nga arritjet e kritereve të mëposhtme nga ana e kandidatit/aplikuesit:

- a) Histori të suksesshme në mësimdhënie, Hulumtim dhe praktikë profesionale së paku 3 vite (pas thirrjes së fundit) (6 semestra).
- b) Diplomë Doktorature, ekuivalente me niveli e 8-të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe vendimi mbi nostrifikimin nga MASHT nëse grada është fituar jashtë Republikës së Kosovës.
- c) Publikime të artikujve në revista me impakt faktor >0 të indeksuara në revista me renome, së paku 3 publikime pas thirrjes së fundit, si autor i parë ose autor korespondent (në rast të mungesës në artikull të autorit korrespondues këtë titull e merr autori i dytë), (Kriteri sipas UA i MASHT_01/2018).
- d) Një apo më shumë libra apo monografi të publikuara në fushën e studimit të kandidatit/aplikuesit (në rast se ka të publikuar temën e Doktoraturës me ISBN atëherë i njihet si vlerë).¹
- e) Pjesëmarrje aktive në së paku 5 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
- f) Udhëheqjen e së paku 5 temave Master prej zgjedhjes së fundit ose ekuivalentin e nivelit të shtatë të KKK.
- g) Të gjitha emërimet bëhen për kohë të pacaktuar. Në aplikim për titullin profesor kërkohet të dëshmohet të ketë arritur thirrjen paraprake akademike (Prof.Ass).

¹ 1. Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë Monografie, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose në vende tjera, me ISBN dhe i kataloguar. Në rastin e kandidatëve që kanë doktoruar në universitetet jashtë Kosovës dhe të vendeve fqinje, mjafton dëshmia e katalogimit të punimeve të doktoratës në biblioteka përkatëse. Kandidati duhet të plotësojë së paku 1 monografi.

2. Tekst mësimor konsiderohet libri në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj, për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku dy recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njejtë ose të afërt dhe të ketë ISBN. Pranohet edhe teksti për përdorim të brendshëm me ligjërata/ushtrime, i botuar në formë të shtypur ose elektronike, i shqyrtuar nga së paku dy recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njejtë ose të afërt. Kandidati për thirrjen profesor i rregullt duhet të ketë së paku një tekst mësimor.

Neni 6 - Profesor asistent

Ofrimi i titullit Profesor Asistent varet nga arritjet e kriterëve të mëposhtme nga ana e kandidatit/aplikuesit:

- a) Histori të suksesshme në mësimdhënie, hulumtim dhe praktikë profesionale së paku 3 vite (6 semestra) në institucione të akredituara të arsimit të lartë.
- b) Diplomë Doktorature, ekuivalente me niveli e 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe vendimi mbi nostrifikimin nga MASHT nëse grada është fituar jashtë Republikës së Kosovës.
- c) Publikime të artikujve në revista shkencore të fushës përkatëse dhe forma tjera të shkrimeve akademike të publikuara nëpër revista shkencore. Së paku një (1) publikim në revistat shkencore me impakt faktor >0 të indeksuara në databaza me renome, si autor i parë ose autor korespondent (në rast të mungesës në artikull të autorit korrespondues këtë titull e merr autori i dytë), (Kriteri sipas vendimit nr.3236/21D të AKA-së të datës 21.09.2021).
- d) Pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në së paku 2 konferenca prej përzgjedhjes së fundit.
- e) Udhëheqjen e së paku 3 temave Bachelor/Master ose ekuivalentin e nivelit të shtatë të KKK.
- f) Emërimet e tilla për tituj profesor asistent bëhen për kohë pesë (5) vjeçare.

Neni 7 - Ligjërues

Ofrimi i titullit Ligjërues varet nga arritjet e kriterëve të mëposhtme nga ana e kandidatit/aplikuesit:

- a) Përfundim i suksesshëm i së paku studimeve Master ekuivalente me niveli e 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve .
- b) Arritje të suksesshme në mësimdhënie, hulumtim dhe praktikë profesionale.
- c) Publikimi i së paku një punimi shkencor në një reviste shkencore të fushës përkatëse si autor i parë ose autor korespondent (kriteri sipas UA i MASHT_01/2018).
- d) Prezantimi i së paku një punimi në konferenca me pjesëmarrje ndërkombëtare
- e) Së paku dy vite (ose 4 semestra) përvojë pune në procesin arsimor në Arsimin e Lartë.
- f) Nota mesatare në studimet Bachelor dhe Master jo më pak se 8.
- g) Në rast të rizgjedhjes të jetë i regjistruar në studimet e Doktoraturës.
- h) Emërimet për këtë titull bëhen në periudhë kohore 3 vjeçare.

Neni 8 - Asistent

Ofrimi i titullit Asistent varet nga arritjet e kriterëve të mëposhtme nga ana e kandidatit/aplikuesit:

- a) Përfundim i suksesshëm i studimeve Bachelor nëse zgjedhja bëhet për programin e nivelit 6-të dhe Master nëse zgjedhja bëhet për nivelin e 7-të.
- b) Në rast të rizgjedhjes të jetë i regjistruar një gradë më lartë se sa në momentin e zgjedhjes.
- c) Nota mesatare në studimet Bachelor dhe Master jo më pak se 8.
- d) Të gjitha emërimet si dhe kohëzgjatja e punësimit zgjatë tre (3) vite.
- e) Më së shumti mund të shkojë 2 herë në rizgjedhje për pozitën e njëjtë.

Neni 9 - Staf akademik vizitor

Kandidatët për Staf Akademik Vizitor duhet të jenë të angazhuar në një institucion tjetër, prej të cilit kanë marrë pushim. Ky staf mund të jetë asistent vizitor, ligjërues vizitor ose profesor vizitor.

Kushtet dhe kriteret e përcaktuara për zgjedhjen e personelit akademik të BprAL Kolegjit Heimerer vlejnë njësoj edhe për anëtarët e personelit të angazhuar, përjashtimisht nëse në konkurs nuk paraqitet asnjë kandidat që plotëson këto kushte dhe kriteret.

Neni 10 - Afatet për të cilat bëhet zgjedhja

10.1. Kolegji HEIMERE hap konkurs për përcaktimin e titujve dhe gradave akademike, dhe për avancimit e stafit Akademik dy (2) herë gjatë një viti Akademik. Në rast të përzgjedhjes së stafit akademik jashtë konkurseve të rregullta përmes një komisioni ad-hoc shqyrtohet dokumentacioni dhe propozohet vendimi për angazhim në Këshillin Akademik.

10.2. Vendimet për përcaktimin e titujve dhe avancimin e stafit akademik merren brenda një periudhe kohore prej një 1_muaji nga organet kompetente sipas kësaj Rregulloreje dhe Statutit.

Neni 11 - Konkursi për zgjedhjen e personelit akademik dhe kushtet e përgjithshme

11.1. Personeli i BPrAL Kolegji Heimerer përbëhet nga personeli akademik dhe personeli administrativ.

11.2. Personeli i BPrAL Kolegji Heimerer mund të jetë i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Çështja e punësimit rregullohet me rregulloren e Brendshme të Punës.

11.3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit të BPrAL Kolegji Heimerer përcaktohen në Rregulloren e Punës dhe kontratat e tyre individuale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11.4. BPrAL Kolegji Heimerer mund të emërojë stafin e posaçëm për pozita mësimdhënëse, hulumtuese dhe administrative ose teknike. Institucioni në statutin e tij do të specifikojë titujt e personelit të posaçëm kërkimor, mësimor, të personelit të lartë administrativ dhe të atij teknik, së bashku me kriteret për zhvillimin profesional, promovimin dhe avancimin brenda këtyre fushave të punës.

11.5. Kushtet specifike për zgjedhjen e personelit akademik përfshijnë kriteret në vijim:

- a) BPrAL Kolegji Heimerer jep thirrje vetëm për kandidatët të cilët kanë ose hynë në marrëdhënie të rregullta kontraktuale me BPrAL Kolegjin Heimerer.
- b) Procedura për zgjedhje ose rizgjedhje do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për gradën akademike.
- c) Konkursi për zgjedhje shpallet nga BPrAL Kolegji Heimerer- me propozim të Dekanateve, varësisht prej nevojave të Dekanateve dhe numrit të mjaftueshëm të orëve (së paku 6 në secilin semestër) që duhet të kenë për t'u zgjedhur ndonjë mësimdhënës apo asistent.
- d) Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozojë Këshillit Akademik shpalljen e konkursit për vend të lira të punës për staf akademik, edhe nëse ai vend nuk është paraparë me propozimin e Dekanatit.
- e) Konkursi duhet të përmbajë referencën e nenit përkatës për zgjedhje në thirrje akademike të Statutit të BPrAL Kolegji Heimerer dhe në këtë Rregullore.
- f) Konkursi shpallet në Web-faqen e BPrAL Kolegji Heimerer dhe/ose në media të shtypura.
- g) Kohëzgjatja e konkursit është së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
- h) Dokumentacioni përkatës sipas konkursit, i shtypur duhet të dorëzohet në Dekanatin përkatës.
- i) Pas mbylljes së konkursit, Dekanatet hartojnë një raport me shkrim në të cilin përfshihen të dhënat me kandidatët të cilët kanë aplikuar, lëndën/ët mësimore për të cilat kanë aplikuar, dhe këtë raport e dorëzojnë në zyrat e Rektoratit specifikisht tek Prorektorati për mësim në BPrAL Kolegji Heimerer.
- j) Pas përpilimit të raportit nga ana e Dekanateve sipas pikës i. të këtij neni, Rektorati, në mbledhjen e Këshillit Akademik të BPrAL Kolegji Heimerer propozon për aprovim komisionin vlerësuese për thirrje akademike.

Neni 12 - Komisionet vlerësuese

12.1 Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik, të cilat përbëhen prej tre (3) anëtarëve. Ky komision mban përgjegjësi ligjore dhe etike për vërtetësinë e përcaktimeve dhe rekomandimeve që bën.

12.2 Në komisione vlerësuese duhet të jetë së paku një (1) anëtarë nga fusha për të cilën është shpallur konkursi.

12.3 Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën duhet të shkruhet vlerësimi, së paku njëri nga anëtarët e komisionit të ketë thirrje akademike më të lartë se sa thirrja që ofrohet.

12.4 Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë të brendshëm dhe të jashtëm (nga IAL të tjera në vend dhe jashtë vendit). Në cilindo rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm - nga BPrAL Kolegji Heimerer. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anetari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit.

12.5 Anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga lëmia përkatëse, sipas ligjit 04/L-037, neni 26.9.

12.6 Dekanët duhet t'ia ofrojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues dhe, po ashtu, me kërkesë të komisionit vlerësues duhet të krijojnë kushte infrastrukturore dhe logjistike për punën më të lehtë të komisionit.

12.7 Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe të hartojë raportin e vlerësimit.

12.8 Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e BPrAL Kolegji Heimerer, rregulloret dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12.9 Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruaj raport vlerësues me propozim konkret për përzgjedhjen, emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik.

12.10 Komisioni vlerësues është i obliguar që të shkruajë raport edhe për kandidatët që nuk i rekomandojnë apo që nuk i plotësojnë kriteret, me një arsyetim përcjellës për secilin kandidat.

12.11 Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga tre (3) anëtarët e komisionit, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Rektorat, i cili raport dërgohet për aprovim në takimin e radhës së Këshillit Akademik.

Neni 13 - Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni vlerësues

13.1 Këshilli Akademik i BPrAL Kolegji Heimerer, pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës (jo më vonë se 10 ditë) të shqyrtojë raportin dhe të konstatojë përfundimin e punëve në lidhje me raportin e komisionit vlerësues dhe të miratojë atë.

13.2 Këshilli Akademik me shumicë votash voton për apo kundër raporteve vlerësuese të Komisionit Vlerësues, për secilin kandidat veç e veç.

13.3 Dekanati, është i obliguar që në afat prej pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së raporteve vlerësuese të miratuara nga ana e Këshillit Akademik, të publikojë ato në buletin, të njejtin ti publikojë në web-faqen e institucionit dhe të njoftoj kandidatin.

13. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese të miratuara nga Këshilli Akademik në Buletin, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Dekanatin përkatës brenda afatit kohorë prej 7 ditësh.

135 Ankesat ndaj vendimeve të Këshillit Akademik, përmes Dekanatit përkatës i drejtohen komisionit të ankesave të BPrAL Kolegjit Heimerer, i cili emërohet nga Këshilli Akademik.

13.6 Këshilli Akademik i BPrAL Kolegjit Heimerer emëron komisionin e ankesave sipas fushave relevante të lëndëve të ankimimit.

13.7 Komisioni për Ankesa i themeluar në nivel të Këshillit Akademik obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i ankesës të shqyrtojë lëndën sipas ankesës dhe të nxjerrë vendimin të cilin duhet dorëzuar në Këshillin Akademik për të marrë vendimin përfundimtar.

13.7 Këshilli Akademik i BPrAL Kolegji Heimerer është i obliguar që pas kalimit të afatit të ankesave, në mbledhjen e radhës, të dërgoj vendimet me emrat e zgjedhur tek Rektori.

Neni 14 – Dispozitat kalimtare dhe hyrja në fuqi

14.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga Rektorja e Kolegjit HEIMERER.

14.2. Të gjitha thirjet akademike dhe titujt të dhënë para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.



Prof.Ass. Dr. Naime Brajshori – Rektore
BPrAL Kolegji Heimerer